

William R. Hite, Jr., Ed.D
Superintendent

8 Shkurt, 2021

Të Dashur Familjarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Të hënën më 8 Shkurt ne hapëm dyert e shkollës për të mirëpritur mësuesit tanë të PreK-2 dhe personelin ndihmës përsëri në ndërtesat e tyre në mënyrë që ata të mund të fillojnë trajnimin e nevojshëm dhe përgatitjen e klasave që është kritike për të pasur mjedise të sigurta mësimi për studentët. Oraret virtuale për dy javët e ardhshme për studentët e PreK-2 u rregulluan posaçërisht për t'u siguruar mësuesve kohën e mjaftueshme për t'u përgatitur për kthimin e studentëve tanë më 22 Shkurt. Kthimi i personelit në ndërtesa reflekton 11 muaj përgatitje të kujdesshme dhe të bazuar në shkencë nga mijëra anëtarë të Drejtorisë të cilët kanë punuar pa u lodhur në shkollat tona për të siguruar që çdo shkollë të ketë masa të sigurisë siç rekomandohet nga Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve dhe Departamentet e Shëndetësisë të Pensilvanisë dhe Filadelfias. Këto përfshijnë:

- protokolle të përmirësuara të pastrimit duke përdorur produkte pastrimi të aprovuara nga EPA,
- konfigurime të reja në klasë dhe banjë për të siguruar distancën sociale,
- Kapacitetin maksimal të përdorimit dhe sigurisë,
- protokollet e para-hyrjes për studentët dhe të rriturit,
- inventarët e PPE për personelin dhe studentët për të mbështetur vënien e maskës së detyrueshme dhe mbulesën e fytyrës gjatë shkollës,
- ndarjet me pleksiglas në zyra,
- stacionet e pastrimit të duarve dhe stacionet e hidratimit në korridore.


Deri më tani, Drejtorija ka shpenzuar rreth 65 milion dollarë për shkak të COVID-19. Kjo përfshin gati 4 milion dollarë në vlerësime, riparime dhe përmirësime të ventilimit për të siguruar rrjedhje të shëndetshme të ajrit, në [përputhje me udhëzimet nga EPA](#). Ventilatorët e dritareve po instalohen përkohësisht në klasat që nuk kanë sisteme ventilimi funksionuese. Përveç kësaj, ne kemi investuar mbi 250 milion dollarë që nga Marsi i vitit 2020 për të: çertifikuar 28 shkolla të tjera si të sigurta për plumb; heqjen mbi 229,000 metra katrorë (pesë hektarë) material që përmban azbest si izolimi i tubave dhe pllaka dyshemeje në 183 shkolla; përfundimin e projekteve të mëdha si laboratorët e rinj të shkencës dhe kompjuterit, rinovimet e banjove, instalimet e dollapëve, azhurnimet e sistemeve mekanike në 11 shkolla; dhe modernizimin e 147 klasave të letërsisë parashkollore .

Të gjitha këto masa dhe përmirësime sigurie shkojnë përtej gjashtë kushteve që Federata e Mësuesve të Filadelfias në mënyrë të qartë negocioi dhe ra dakord në një Memorandum të Marrëveshjes për kthimin e sigurtë të personelit në ndërtesat e shkollës: pastrimi dhe dezinfektimi i gjithë ndërtesës së shkollës; pajisje të mjaftueshme për larjen e duarve, stacioneve të pastrimit të duarve në shkolla; pastrues për duart në dispozicion të personelit ; ndarëse pleksiglas të instaluar në zyrat e shkollës; ekzistojnë protokollet e distancimit social; dhe maska prej pëlhure të siguruara në përputhje me Protokollin e PPE.

Të gjithë ne ndajmë qëllimin e përbashkët për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e studentëve dhe personelit tonë ndërsa rifillojmë mësimin në - person gjatë kësaj pandemie COVID-19. Shkenca nga CDC është e qartë se kur ekzistojnë masat e duhura të sigurisë, rreziku i transmetimit është i ulët. Të gjitha këto masa sigurie janë të vendosura. Ndërsa mësuesve tanë dhe anëtarëve të tjerë të PFT-së nuk u kërkohet të kthehen në shkolla në këtë kohë pasi ne presim hapat e ardhshëm nga ndërmjetësi, ne vazhdojmë t'i inkurajojmë ata që të kthehen në shkolla kështu që ne jemi të përgatitur për 9,000 nxënës PreK-2, familjet e të cilëve dëshirojnë dhe kanë nevojë që fëmijët e tyre të rifillojnë mësimin në - person në 22 Shkurt. Njerëz të tjerë në shkolla do të ndihmojnë gjithashtu për të identifikuar çdo çështje që mund të adresojmë përpara se studentët të kthehen. Ne jemi gjithashtu të gatshëm për të punuar me Qytetin e Filadelfias dhe Spitalin e Fëmijëve të Filadelfias në një përpjekje për të bërë të disponueshme vendet e vaksinimit shkollor në të gjithë qytetin, në mënyrë që personeli ynë të vaksinohet pasi të jenë të mundshme vaksinat.

Ne i bëjmë jehonë ndjenjës se të gjithë jemi në këtë së bashku. Kjo është arsyeja pse ne jemi angazhuar në diskutime të vazhdueshme me ekspertë të shëndetësisë, zyrtarë të qytetit dhe të gjitha sindikatat e Drejtorisë Arsimore gjatë gjithë këtij procesi. Ne jemi duke pritur hapat e ardhshëm në procesin e ndërmjetësimit nga Qyteti në mënyrë që të mund të zgjidhim çdo çështje të identifikuar dhe të vazhdojmë së bashku pa vonesë.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.

Superintendent

Drejtoria Arsimore e Filadelfias